



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPSTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipal Kaçanik

|          |                   |       |         |
|----------|-------------------|-------|---------|
| Data     | 13.03.2026        | Vendi | Kaçanik |
| Nj. org. |                   | Numri | Shtojce |
|          | 10-104/02-6217/26 |       |         |

---

## DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

### THIRRJE PËR APLIKIM

Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Kioskave

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm (DZHET) në Komunën e Kaçanikut, në bazë të nenit 1 të Rregullores Nr. 03/2020 me nr. 01Nr.02-04/02-26493/20 të datës 23.11.2020 , për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës për periudhën kohore më pak se një (1) vit shpall këtë thirrje për aplikim:

- Dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të 10 kioskave të reja në rr. Ismail Raka dhe sheshin e qytetit.

Qëllimi i kësaj thirrje është sistemimi dhe zhvillimi i veprimtarive afariste në këtë zonë, përmes vendosjes së kioskave të reja dhe krijimit të kushteve më të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

Kushtet financiare për pagesa të qirasë mujore janë të parapara me Rregulloren me nr.01Nr.104/02-8228/2025 të datës 30.05.2025.

Duke u bazuar ne Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Komunale vendosja e kioskave ose objekteve tjera montuese (lëvizëse) për veprimtari tregtare në zonën I çmimi për muaj është 6 €/m2.

#### **Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së kioskave**

- Biznesi duhet të jetë i regjistruar në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) para datës së publikuar të kësaj thirrje,
- Të jetë banor rezident i komunës se Kaçanikut,
- Të ndikoj në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë,
- Të ketë arsyeshmërinë të interesit publik,
- Të ndikoj në rritjen e vlerave të diversitetit arsimor, kulturorë-sportiv e të ngjashme,
- Me qëllim të sigurimit të diversitetit të veprimtarive ekonomike dhe shmangies së dominimit të një veprimtarie ekonomike nuk mund të përfaqësoj më shumë se 30% të numrit të përgjithshëm të kioskave të dhëna në shfrytëzim nga komuna.

#### **Dokumentet e nevojshme për aplikim**

- Kopje të Certifikatës së Biznesit me informata përcjellëse,
- Kopje te letërnjoftimit të pronarit-pronares së Biznesit,
- Vërtetim mbi tatimin në pronë,
- Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara.

Linku për shkarkimin e formularit:

<https://kacanik.rks-gov.net/shpalljet/>

### **Qëllimi i përdorimit të kioskave**

- Shitja e produkteve ushqimore (fast food / snack),
- Shitja e akullores dhe pijeve freskuese (smoothie, lëngje frutash),
- Shitja e produkteve sezonale si (misër, gështenja, dhe produkte të ngjashme),
- Shitja e lodrave dhe produkte për fëmijë,
- Shitja e produkteve vendore tradicionale,
- Shitja e parfumeve dhe kozmetikës,
- Shitja e produkteve dekorative dhe dhuratave,
- Shitja e produkteve bio organike (mjaltë, çajra bimore, produkte natyrale),
- Suvenire ose produkte artizanale,
- Libra ose produkte të ngjashme kulturore.

### **Përparësitë**

- Bizneset që veprojnë aktualisht me kioska,
- Bizneset individuale ( B.I.),
- Përvojë më të gjatë në biznes,
- Familjet e Dëshmorëve dhe Invalidët e luftës,
- Veteranët e Luftës,
- Aplikuesi/ja me aftësi të kufizuara,
- Gjinia femërore,
- Personat nën moshën 35 vjeçare,

### **Kushtet e mirëmbajtjes**

- Biznesi duhet ta mbajë kioskën dhe hapësirën përreth të pastër,
- Fituesi obligohet që me shpenzimet e veta të bëjë lidhjen e kioskës në energji elektrike,
- Duhet të paguaj energjinë elektrike dhe shërbimet komunale,
- Ndalohet ndryshimi objektit pa leje të Komunës,
- Fituesi i kioskës nuk ka të drejtë ta japë kioskën me qira apo në shfrytëzim një personi tjetër.

## Kriteret jo kualifikuese

- Nuk lejohet aktivitetet që pengojnë në funksionimin normal të shëtitores,
- Një aplikant nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikacion në këtë thirrje publike,
- Biznesi që ka ndikim negativ në ambient ,
- Ndalohet çfarëdo lloj objekti apo sendi i luajtshëm apo i paluajtshëm rreth kioskës.

## Afati i fundit për aplikim

Afati i aplikimit është nga data 13.03.2026 deri me datën 27.03.2026

Aplikacionet e kompletuara në një kopje fizike duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në Qendrën për Shërbime me Qytetarë (QSHQ), Komuna Kaçanikut me shënimin “Thirrje publike Dhënie në shfrytëzim të Kioskave”, si dhe emri i plotë i aplikuesit.

Aplikacionet e pranuar pas përfundimit të këtij afati nuk do të merren parasysh në çfarëdo rrethane.

Drejtoreshë e DZHET

Arlinda Rakoci-Raka





**Republika e Kosovës**

Republika Kosova

Republic of Kosovo



**Komuna e Kaçanikut**

Opština Kaçanik

Municipal Kaçanik

---

**DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE  
TURIZËM  
THIRRJE PËR APLIKIM  
Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Kioskave**

| <i>I. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË APLIKANTIT</i> |  |
|---|--|
| 1. Emri dhe Mbiemri:                              |  |
| 2. Datëlindja:                                    |  |
| 3. Gjinia:  | <input type="checkbox"/> Femër <input type="checkbox"/> Mashkull         |
| 4. Numri personal:                                |  |
| 5. Vendbanimi:                                    |  |
| 6. Profesioni:                                    |  |
| 7. Etniciteti:                                    | <input type="checkbox"/> Shqiptar <input type="checkbox"/> Tjetër: _____ |
| 8. Numri telefonit:                               |  |
| 9. E-mail adresa:                                 |  |
| <i>II. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË BIZNESIT</i>  |  |
| 10. Emri i Biznesit:                              |  |
| 11. Nr. Unik i Biznesit                           |  |

|  |   |
|--|---|
| 12. Statusi Legal i Biznesit:  | <input type="checkbox"/> Biznes Individual <input type="checkbox"/> SHPK <input type="checkbox"/> tjetër<br>_____ |
| 13. Pronari i Biznesit:  |   |
| 14. Adresa e Biznesit:   |   |
| <b>III. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT/PLANIT TË BIZNESIT</b>     |   |
| 15. Përshkruani gjendjen e tanishme të Biznesit tuaj :               |   |
| 16. Çka planifikoni të punoni nëse përzgjidheni përfitues i kioskës: |   |

|   |            |
|---|------------|
| <b>IV. Përshkruani strukturën organizative të biznesit tuaj:</b>  |            |
| Punonjës me orar të plotë / nëse keni sa janë?  |            |
| Punonjës me kohë të pjesshme / nëse keni sa janë?   |            |
| Punonjës me nevoja të veçanta:  |            |
| Aplikanti vërteton se informacioni i dhënë këtu është i vërtetë sipas njohurive të tij, dhe pranon detyrimin për të respektuar afatet dhe kushtet e DZHET-së / Komunës të cilat janë në fuqi në kohën e dhënies së kioskave |            |
| _____ Nënshkrimi  | _____ Datë |